



Datë: 16.12.2025

Numër Protokolli: 7913/2025

A.nr.1273/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.696/2023 të datës 05.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, i plotfuqishëm sipas Aktgjykimit AA.nr.820/2023 të datës 13.01.2025, të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamentit për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.303/2023 të datës 02.02.2023, të parashtruar nga ankuesja N.P të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Xhevdet Smakiqi nga Prishtina, në çështjen juridike “*Shkelje e të drejtës në pagë*”, në mbështetje të nenit 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, nenit 16, paragrafi 3 dhe nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.303/2023 e datës 02.02.2023, e parashtruar nga ankuesja N.P.

A r s y e t i m

Ankuesja N.P (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 02.02.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndaj kërkesës për ngritje të koeficientit, nga koeficienti aktual shtatë (7) në koeficientin e pagës tetë (8).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa kjo e fundit, ka dërguar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1245/2023 e datës 02.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 01.02.2023; Akt emërimit e datës 06.06.2023; Kontratën e marrëdhënies së punës e datës 09.06.2010, e datës 01.07.2007, e datës 01.06.2006, e datës 01.06.2004; Përgjigjen në kërkesë e datës 27.01.2023; Kërkesën për ngritje të koeficientit e datës

22.12.2022; Kërkesën për ngritje të koeficientit e datës 18.06.2018 dhe 18.04.2014; Kërkesën për avancim të ankueses e datës 21.01.2010, e datës 14.10.2009, e datës 24.02.2009; Emailin e datës 17.01.2023 nga ankuesja për Xh.M; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për ankuesen datë 19.01.2023, i datës 18.12.2011; Vendimin për Leje ndërtimore i datës 19.01.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 28.02.2023; Listën e pagave dhjetor 2022 për ankuesen; Listën e pagave janar 2023 për ankuesen; Vendimin A.nr.303/2023 i KPMSHCK-së; Aktgjykimin A.nr.696/2023 e Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ankesën për Gjykatën e Apelit e datës 25.10.2023; Aktgjykimin AA.nr.820/2023 i Gjykatës së Apelit të Kosovës; Kërkesën për prova shtesë e datës 21.11.2025; Përgjigjen e datës 09.12.2025; Dosjen e zyrtarëve V.P, Xh.M dhe D.Sh.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është pabazuar, **sepse:**

Gjendja e fakteve:

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë:

- Ankuesja sipas aktit të emërimit të datës 06.06.2013, është e punësuar në pozitën Zyrtare e Rregullatives Teknike në MMPHI.

- Më datë 22.12.2022, ankuesja ka parashtruar kërkesë të zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, për ngritjen të koeficientit nga shtatë (7) në koeficientin tetë (8), ndërsa, përmes përgjigjes në ankesë të datës 27.01.2023, Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore e MMPHI-së, ka njoftuar ankuesen se e njëjta mban pozitën me koeficient sipas aktit të emërimit, ndërsa, çdo ndryshim duhet të kaloj përmes procedurave sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe si dhe Rregullores për Pranim në Shërbimin Civil.

-Ankuesja më datë 02.02.2023, parashtron ankesë në Këshill duke pretenduar se në vazhdimësi ka dërguar kërkesa për ngritjen e koeficientin mirëpo që nuk është arritur qëllimi e në këtë rast jam diskriminuar në vazhdimësi, duke shtuar tutje se pretendimet e saj janë të ligjshme dhe institucioni duhet të përcaktoj koeficientin për pozitën e saj tetë (8). Ka kërkuar që ankesa të aprovohet dhe të detyrohet ministria të bëjë harmonizimin e koeficientit nga shtatë (7) në koeficientin tetë (8).

- Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë duke vepruar sipas ankesës së ankuese stë datës 02.02.2023, më Vendim A.nr.303/2023, të datës 06.03.2023, ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të ankesës së ankueses, mbi bazën se në kohën e vendimmarrjes ishte miratuar Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili ka përcaktuar se ndalohej çdo ndryshim në strukturën, komponentët dhe nivelet e koeficienti të pagës.

-Ankuesja kundër Vendimit të Këshillit A.nr.303/2023, të datës 06.03.2023, ka iniciuar konflikt administrativ në gjykatën kompetente, gjegjësisht Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa, kjo e fundit më Aktgjykimin A.nr.696/2023 të datës 05.10.2023, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar vendimin e Këshillit dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

- Kundër Aktgjykimit A.nr.696/2023 të datës 05.10.2023, Këshilli ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (datë 25.10.2023).

-Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 13.01.2025 ka nxjerr Aktgjykim AA.nr.820/2023, më të cilin ka refuzuar ankesën e Këshillit duke e vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit duke marrë parash qëndrimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative si në Aktgjykimin A.nr.696/2023 të datës 05.10.2023 si dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamentit për Çështje Administrative si në Aktgjykimin AA.nr.820/2023 të datës 13.01.2025 në ri procedurë ka kërkuar prova shtesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës referuar pretendimit për diskriminim të ankueses dhe nga analizimi i provave materiale të disponueshme ka konstatuar se ankuesja sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës me numër të kontratës 210 të datës 01.06.2004, kishte themeluar marrëdhënie punë në MMPHI, në pozitën Nëpunës i rregullatives teknike me koeficient shtatë (7), pozitë të cilën fillimisht e ushtronte sipas kontratës të punës bazuar në legjislacionin e UNMIK-ut, ndërsa, më datë 06.06.2013, ankueses i është lëshuar Akt Emërimi pa afat të pacaktuar mbi bazën e nenit 12 paragrafi 1.1 dhe nenit 97 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Rregullores Nr. 07/2-1- për Emërimin e Nëpunësve Civil, me koeficient shtatë (7) të pagës. Ndërsa, zyrtarja V.P kishte themeluar marrëdhënie pune në MMPH sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës me numër të kontratës 226 të datës 10.08.2004, në pozitën Zyrtare për Planifikim me koeficient shtatë (7) pozitë të cilën e ka ushtruar deri më datë 20.1.2008, ku më pastaj sipas Vendimi nr. protokolli 08/2573/1 të datës 21.11.2008, të Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së ishte avancuar në pozitën Udhëheqëse e Sektorit për Bashkëpunim Ndërkomunal me koeficient tetë (8), pozitë, të cilin e kishte ushtruar deri më 30.06.2015, ku më datë 01.07.2015, të njëjtës i është lëshuar Akt Emërimi me afat të pacaktuar në pozitën Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Ndërkomunal me koeficient tetë (8) të pagës. Zyrtari Xh.M sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës të datës 15.10.2003, ka krijuar marrëdhënie punë në MMPH, në pozitën e punës Nëpunës i Rregullatives Teknike me pagës prej 217 Euro, pozitë të cilën e ka ushtruar deri më datë 07.04.2009, ku më pastaj, sipas Vendimit më nr. protokolli 08/2049/1 të datës 24.09.2008 të Sekretarit të Përgjithshme të MPMH-së, ishte avancuar në Udhëheqës i Sektorit për Rregullativë Teknike me koeficient tetë (8), pozitë të cilën e ka ushtruar deri me datë 07.04.2009, ndërsa, më datë 08.04.2009 fillimisht ishte caktuar ushtrues i detyrës së Udhëheqësi të Divizionit të Ndërtimit me koeficient nëntë (9), e me pastaj pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit i njëjtë ishte emëruar në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Ndërtimit (akti i emërimit të datës 27.11.2014). Zyrtarja D.Sh kishte themeluar marrëdhënie pune në MMPH sipas Kontratës së Marrëdhënies së Punës me numër të kontratës 243 të datës 01.12.2004, në pozitën Zyrtare për Politika Komunale të Banimit me koeficient shtatë (7), pozitë të cilën ka mbajtur deri më datë 23.09.2008, më pastaj sipas Vendimit më nr. protokolli 08/2051/1 të datës 24.09.20208, të Sekretarit të Përgjithshme të MPMH, ishte avancuar në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Politika të Banimit me koeficient tetë (8), pozitë të cilën e ka ushtruar deri më 31.08, 2014.

Rrjedhimisht, siç u konstatua më sipër avancimi i zyrtareve V.P, D.Sh dhe Xh.M ishte bërë sipas rregullativës së UNMIK-ut në fuqi në atë kohë, gjegjësisht Urdhëresës Administrative Nr.2003/2 për Zbatimin e Rregullores së UNMI-ut Nr.2001/36 për Shërbimin Civil, e zbatueshëm deri më datë

10.07.2010 dhe se ky avancim nuk ishte zbatuar në raport me ankuesin. Ne fakt, më datë 10.07.2010, ka hyr në fuqi Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e më të cilin është rregulluar statusi i nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në institucionet e administratës qendrore dhe komunale, dhe për rrjedhojë nga koha e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha procedurat e marrëdhënies së punës për nëpunësit civil janë rregulluar sipas këtij ligji, duke përfshirë avancimin dhe çështjet e tjera, kështu që, edhe procedura e avancimit në një pozitë më të lartë funksionale ose gradë lejohej vetëm sipas procedurës së paraparë më nenin 27 të Ligjit. Andaj, pas këtyre rrethanave juridike, zyrtaret V.P, Xh.M dhe D.Sh, kanë vazhduar të realizojnë pagë sipas pozitës së avancuar, ndërsa, ankuesja, ka realizuar page sipas koeficient të përpara më Akt Emërim, ashtu siç përcaktohej më 9 paragrafin 1, të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku citojmë: *“Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës”*.

Duke qenë së ankuesja deri më datën e parashtrimt të ankesës në Këshill nuk ka arritur të argumentoj me prova materiale se e njëjta kishte parashtruar ndonjë kërkesë apo ankesë lidhur me pretendimet për ngritje në pozitë apo për rregullim të koeficientit sikurse koleget e saj, Kolegji i Këshillit thekson së pretendimet e ankueses janë të pabazuar mbi arsyet së avancimi në pozitë mund të bëhej vetëm nëpërmjet procedurave ligjore sipas nenit 27 të Ligjit 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës i aplikueshëm deri më datë 25.09.2023, ndërsa, nga data 05.02.2023 sipas dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Rrjedhimisht, duke qenë së pala ankuese kishte parashtruar ankesë në kohën kur ishte miratuar Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, e meqenëse Këshilli në procedurë kishte vendosur në kohën kur ishte në fuqi ky ligj, atëherë pas konstatimit së ankuesja nuk posedonte dëshmi për ngritje te koeficientit nga organi i punësimit sipas Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, kolegji ka trajtuar pretendimet ankimore në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. E në këtë kontekst, kolegji thekson faktin se Ligji 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ka ndaluar çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave dhe si pasojë nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Andaj, marrë për bazë konstatimet si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1237/2023

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat Xhevdet Smakiqi;
- Liridona Ajeti Kajtazi, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë
-Departamenti për Çështje Administrative;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.